



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1214/1 Prot.

Tiranë, më 25.06.2026

V E N D I M

Nr. 175, Datë 25.06.2026

Duke marrë indicien nga informacioni¹ i dhënë nga Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT, sinjalizimit² nga Ambasada e Republikës Federative të Brazilit dhe raportimeve në media, lidhur me vendimin e Federatës Shqiptare të Volejbollit për pezullimin e lojtares së Klubit të Volejbollit Dinamo, N.F, duke i kërkuar që ti nënshtrohet testit të gjinisë dhe duke ngritur dyshimin për cenimin e saj në dinjitetin personal dhe profesional, mbështetur në nenin 41/2/a³ të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, si dhe në nenin 32, pika 1, shkronjat c), f) dhe pika 2, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, me Urdhrin nr. 138, datë 17.11.2025, Komisioneri ka filluar ndjekjen kryesisht të çështjes së sportistes znj. N.F.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Referuar informacionit të përcjellë, ndër të tjera pretendohet se: “Znj. N.F është pezulluar nga të gjitha aktivitetet zyrtare nga Federata Shqiptare e Volejbollit, bazuar në pretendimin se është akuzuar nga përfaqësues të ekipeve të tjera se “nuk është grua”. Ajo iu nënshtrua në mënyrë arbitrare dhe diskriminuese kërkesave mjekësore dhe testeve të “verifikimit të gjinisë”, pa asnjë bazë ligjore, justifikim formal apo transparencë në lidhje me standardet e aplikuara. Pas kësaj, asaj iu kërkuua madje t’i nënshtrohej një analize më të thelluar në lidhje me gjininë e saj.

¹ Referuar email-it datë 23.10.2025.

² Shkresa nr. 19/2025, datë 11.11.2025.

³ “Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës...”.

Znj. N.F është një volejbolliste ndërkombëtare e respektuar dhe me përvojë, e cila ka një karrierë jashtëzakonisht të qëndrueshme. Sipas CV-së së saj, ajo ka qenë pjesë e klubeve të volejbollit si BMB/Mackenzie, San Bernardo, Sesi, Pinheiros, në Brazil; ose Gran Canaria, në Spanjë; Kravole Pole, në Republikën Çeke; LP Vampula në Finlandë, Vitoria dhe Kairos në Portugali, përveç klubeve në Arabinë Saudite.

Znj. N.F është qartësisht një grua, me të gjitha dokumentet e saj civile dhe sportive, duke përfshirë dokumentet personale dhe regjistrimet zyrtare në Konfederatën Braziliene të Volejbollit (CBV) dhe Federatën Ndërkombëtare të Volejbollit (FIVB).

Në mungesë të çdo prove që lidhet me parregullsi, performancë të dyshimtë apo kërkesë nga klubi i saj, vendimi i Federatës është marrë në bazë të pretendimeve subjektive të disa ekipeve rivale, që sipas dokumenteve, vetë Federata i ka konsideruar si “ankesa mbi gjendjen fizike dhe fiziologjike të sportistes”. Këto pretendime, të bazuara dukshëm në perceptime mbi pamjen e jashtme të sportistes, nuk mund të përbëjnë kurrësi shkak të ligjshëm për nisjen e një procedure që cenon dinjitetin personal dhe privatësinë e saj, aq më tepër kur nuk është ndjekur asnjë procedurë e rregullt administrative apo sportive, për hetim paraprak e konsultim dhe nuk i është ofruar sportistes asnjë garanci procedurale për verifikimin e situatës. Nëse do të kishte ekzistuar një çështje e brendshme e ngritur nga vetë klubi apo një analizë teknike mbi diferencat e performancës në skuadër, ajo mund të ishte trajtuar përmes procedurave të rregullta sportive.

Kjo qasje përbën shkelje të detyrimeve ligjore për mbrojtjen e dinjitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Federata në vendimarrjen e saj, është bazuar dhe ka legjitimuar perceptime stereotipike dhe paragjyquese, në vend që të siguronte mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të sportistes, ti ofronte mundësinë sportistes që të dëgjohej apo të mbrohej, siç kërkohet nga ligji shqiptar dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në rastin në fjalë jemi përpara një kërkesë joproporcionale për të provuar gjininë ndaj një lojtareje, në kushtet ku ky provim i gjinisë nuk u kërkohet lojtareve të tjera në të njëjtën pozitë me të.

Faktet e përmendura më sipër përbëjnë diskriminim gjinor, në kundërshtim me parimet e dinjitetit njerëzor, barazisë dhe mosdiskriminimit të sanksionuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe traktate të tjera ndërkombëtare që mbrojnë gratë”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa a), c) dhe f), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*gjinisë*” duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Neni 5, i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “*1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre*”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë.

- Me shkresën nr. 1582/2, datë 17.11.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Federata Shqiptare e Volejbollit (FSHV).
- Me shkresën nr. 1582/4, datë 22.12.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kujtuar FSHV-në për dhënien e informacionit të kërkuar me shkresën nr. 1582/2, datë 17.11.2025.

Me shkresën nr. 349, datë 31.12.2025, Federata Shqiptare e Volejbollit, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “*Volejbollistja N.F luan për Shoqatën Dinamo në kampionatin e femrave 2025–2026. Pas ndeshjes Vllaznia–Dinamo (28.09.2025, 1-3), përfaqësuesit e Vllaznisë kërkuan me shkrim vlerësim psikologjik dhe ekzaminime laboratorike, pasi vunë re një forcë sulmuese mbi normalen e pritur tek lojtarja. Me datë 03.10.2025, klubi i Pogradecit, përpara ndeshjes së planifikuar për datë 11.10.2025, kërkoi që FSHV të kryente analiza antidoping dhe verifikim të*

përshtatshmërisë fizike/fiziologjike të lojtares, duke shprehur shqetësim për dëmtime të mundshme ndaj lojtareve të tjera.

Me shkresën nr. 251, datë 06.10.2025, Bordi Drejtues i FSHV vendosi kryerjen e ekzaminimeve për “vërtetimin e performancës fizike natyrale dhe përcaktimin e gjinisë” – term mjekësor që nënkupton testin e kromozomit SRY dhe testin e testosteronit, të kryera me marrje gjaku. U ngrit një grup pune (Sekretari i Përgjithshëm, mjek i ASHSH, mjeku i Dinamos). Klubi Dinamo u njoftua zyrtarisht (13.10.2025) për paraqitjen e lojtares me datë 15.10.2025 në Spitalin Salus.

Lojtarja nuk u paraqit më 15.10.2025 (procesverbal nr. 255). Bordi i dha një mundësi të dytë (vendim nr. 260, 16.10.2025) për datën 22.10.2025. Në këtë datë, lojtarja u paraqit në spital e shoqëruar nga përfaqësuesja e klubit dhe një përkthyes, mori informacionin mbi protokollin spitalor dhe formularin e pëlqimit, pati kohë një orë për të vendosur, por në fund refuzoi si kryerjen e analizave ashtu edhe nënshkrimin e formularit të refuzimit, dhe u largua (ora 13:15). Fatura e analizave u anulua pasi këto nuk u kryen.

Procedura bazohet në Rregulloren e Brendshme, Statutin e FSHV-së, Ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, dhe protokollin e FIVB. Statuti (Neni 1.2 dhe Neni 3.2) ngarkon FSHV-në me detyrimin për të kontrolluar dhe rregulluar aktivitetin sportiv dhe për të zgjidhur problematikat tekniko-organizative. Ligji nr. 79/2017 (neni 3.6 dhe neni 18.1.a) i njej federatës kombëtare kompetencën të organizojë, drejtojë dhe kontrollojë aktivitetet zyrtare sipas rregulloreve të miratuara.

FIVB konfirmoi me email (09.10.2025) se çështjet e përcaktimit gjinor në kompeticionet kombëtare janë në autoritetin e federatës kombëtare – pra kompetencë ekskluzive e FSHV-së. Neni 7 i Statutit dhe neni 29 i Ligjit nr. 79/2017 detyrojnë anëtarët dhe sportistët të respektojnë rregullat dhe vendimet e federatës.

FSHV thekson se procedura u krye duke respektuar plotësisht privatësinë dhe dinjitetin e lojtares, dhe ka ruajtur konfidencialitetin gjatë gjithë procesit – çështja u bë publike nga klubi Dinamo dhe nga vetë sportistja, jo nga FSHV. Vendimi nr. 247 (06.10.2025) konsiderohet tërësisht i ligjshëm dhe konform rregullave sportive.

FSHV mohon çdo akt diskriminimi: lojtarja u njoftua zyrtarisht nga klubi i saj, pati shoqërim dhe përkthyes, dhe pati kohë të mjaftueshme për të vendosur. Refuzimi i saj për t’iu nënshtruar ekzaminimeve vuri në dyshim përshtatshmërinë e saj dhe e detyroi FSHV-në, sipas Rregullores së Brendshme dhe Kodit Etik, të vendosë pezullim të përkohshëm, masë e justifikuar vetëm nga mosrespektimi i vendimit të Bordit, jo nga ndonjë shkak tjetër.

FSHV deklaroi se ka mbetur e hapur dhe bashkëpunuese, duke i dhënë lojtares një shans të dytë, por bashkëpunimi u refuzua nga klubi dhe nga vetë sportistja. Në përfundim, FSHV vlerëson se procedura e ndjekur është në përputhje me ligjin, statutin dhe parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, dhe se mbetet e përkushtuar ndaj parimeve të Fair Play dhe lojës korrekte”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, Klubi i Volejbollit Dinamo dhe sportistja N.F nëpërmjet email-it datë 08.01.2026, janë njohur me përgjigjen e FSHV-së, por nuk kanë kthyer përgjigje.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 309, datë 09.02.2026 njoftoi palët për seancë në datë 19.02.2026. Përfaqësuesja e ankueses, Av. D.N, e pajisur me Prokurën e Posaçme nr. repertori 2746, nr. koleksioni 945, datë 29.11.2025, me email-in datë 11.02.2026, ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore për arsye se nuk mund të merrte pjesë. Për këtë arsye Komisioneri me shkresën nr. 357, datë 16.02.2026 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 10.03.2026. Ditën e seancës dëgjimore, Sekretari i Përgjithshëm i FSHV-së është kontaktuar në telefon dhe ka informuar se për shkak të një emergjence shëndetësore në familje kërkon shtyrjen e seancës dëgjimore. Për këtë arsye, Komisioneri me shkresën nr. 357/2, datë 11.03.2026, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 25.03.2026. Sekretari i Përgjithshëm i FSHV-së me email-in datë 23.03.2026, njoftoi se për arsye të një udhëtimi pune jashtë vendit, nuk mund të marrë pjesë në seancë. Me email-in datë 24.03.2026, Sekretari i Përgjithshëm i FSHV-së është informuar që mund të autorizonte një person tjetër për të marrë pjesë në seancë.

Seanca dëgjimore u zhvillua vetëm me praninë e përfaqësueses së znj. N.F, Av. D.N, e cila dorëzoi parashtrimet me shkrim dhe kopje të kontratës të sportistes me Akademinë e Volejbollit Dinamo.

Në parashtrimet me shkrim të dorëzuara nga përfaqësuesja e sportistes N.F, Av. D.N, në mes të tjerash informon se: *“Sportistja është e regjistruar në dokumentet e identifikimit dhe në çdo evidencë sportive si lojtare femër dhe luan në ndeshjet e kategorisë së femrave prej afro 15 vitesh, si pjesë e ekipeve të ndryshme në nivel ndërkombëtar.*

Gjatë muajit Tetor 2025, znj. N.F ka qenë subjekt i një serie komunikimesh zyrtare dhe vendimmarrjesh nga Federata Shqiptare e Volejbollit, si vijon:

1. *Më datë 06.10.2025, Bordi Drejtues i Federatës Shqiptare të Volejbollit ka nxjerrë vendimin me nr. 247 me objekt: “Mbi ekzaminimet e nevojshme për kryerjen e analizave përkatëse për vërtetimin e performancës fizike natyrale dhe përcaktimin e gjinisë për lojtaren N.F”.*
2. *Më datë 13.10.2025, Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Volejbollit i ka dërguar Klubit Dinamo një shkresë përmes së cilës kërkohej që sportistja të paraqitej pranë Spitalit Salus për kryerjen e analizave të kërkuara.*
3. *Më datë 16.10.2025, Klubi i Volejbollit Dinamo i është drejtuar Federatës me një kërkesë për reflektim dhe mbrojtje të reputacionit të sportistes, duke kërkuar rishqyrtimin e vendimit.*
4. *Në të njëjtën datë, Federata i është përgjigjur kësaj kërkesë duke konfirmuar se vendimi ishte marrë në përputhje me rregulloret e saj dhe se çështjet që lidhen me përcaktimin e gjinisë në kompeticionet kombëtare janë në kompetencë të federatës kombëtare.*
5. *Po në datën 16.10.2025, Bordi Drejtues i Federatës Shqiptare të Volejbollit ka marrë vendimin për pezullimin e përkohshëm të sportistes nga aktivitetet sportive për shkak të mosparaqitjes së saj për kryerjen e analizave.*

6. Që prej kësaj date, sportistja N.F është pezulluar nga aktivitetet sportive dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë ndeshje të zhvilluar nga ekipi i saj.

Federata argumenton se procedura është iniciuar pas kërkesave të paraqitura nga dy klube të kampionatit, të cilat kanë ngritur shqetësime lidhur me performancën fizike të sportistes dhe me faktin se ajo kishte një forcë goditëse “mbi normalen e pritur”. Një pretendim i tillë nuk përbën provë objektive që mund të justifikojë ndërmarrjen e një procedure kaq intruzive ndaj një sportisteje profesionale.

Performanca fizike, forca apo karakteristikat atletike nuk mund të përdoren si bazë për të vënë në dyshim gjininë e një sportisteje, pasi një qasje e tillë mbështetet në stereotipe gjinore dhe jo në kritere objektive. Nëse perceptime të tilla subjektive do të konsideroheshin të mjaftueshme për të iniciuar procedura të tilla, atëherë çdo sportiste që shfaq performancë më të lartë se mesatarja mund të bëhej subjekt i dyshimeve dhe ekzaminimeve të ngjashme.

Federata argumenton se procedura e ndjekur është bazuar në Statutin e saj, në rregulloren e brendshme dhe në ligjin për sportin.

Megjithatë, në dokumentacionin e paraqitur nuk identifikohet asnjë dispozitë konkrete që të autorizojë Federatën të kërkojë nga një sportiste kryerjen e analizave për përcaktimin e gjinisë, përfshirë testin e kromozomit SRY apo testin e nivelit të testosteronit.

Për më tepër, nuk rezulton të jetë parashikuar:

- Një procedurë e qartë për raste të tilla;
- Kriteret objektive që duhet të përmbushen për fillimin e procedurës;
- Garancitë procedurale për sportistin, sidomos lidhur me periudhën tranzitore mes kryerjes së testeve dhe daljes së rezultateve;
- Një mekanizëm ankimi kundër një vendimi të tillë.

Në mungesë të këtyre elementeve, ndërhyrja e Federatës përbën një masë arbitrare, të pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

Nga faktet, rezulton se vetëm ndaj sportistes N.F është kërkuar kryerja e analizave për përcaktimin e gjinisë. Federata nuk ka paraqitur asnjë rast tjetër ku sportistet e tjera të kampionatit të kenë qenë subjekt i një procedure të ngjashme. Ky trajtim i diferencuar vendos sportisten në një pozitë më pak të favorshme në raport me sportistet e tjera që ndodhen në rrethana të krahasueshme dhe përbën një element tipik të diskriminimit të drejtpërdrejtë.

Federata argumenton se pezullimi i sportistes nuk lidhet me ndonjë formë diskriminimi, por vetëm me mosrespektimin e vendimit të Bordit Drejtues për kryerjen e analizave.

Nëse vetë kërkesa për kryerjen e analizave është e pajustificuar dhe diskriminuese, atëherë edhe sanksioni i vendosur për refuzimin e saj është ligjërisht i pabazuar. Refuzimi i një personi për t’iu nënshtruar një procedure invazive që cenon integritetin fizik dhe dinjitetin e tij, në mungesë të procedurave dhe standardeve ligjore që do të shërbenin si bazë për këtë lloj kërkesë, nuk mund

të përdoret si bazë për marrjen e një mase disiplinore. Në këtë kuptim, pezullimi i sportistes përbën një formë sanksioni për shkak të ushtrimit të së drejtës së saj për të mbrojtur dinjitetin dhe integritetin e saj personal.

Nga analiza e fakteve dhe e argumenteve të paraqitura nga Federata rezulton se procedura e ndjekur ndaj sportistes N.F është bazuar në dyshime subjektive, pa prova objektive dhe pa një bazë të qartë ligjore”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se:

Në datë 27.05.2025, mes Akademisë së Klubit të Volejbollit Dinamo dhe sportistes N.F, është lidhur kontrata e punës mes palëve në të cilën sportistja do të aktivizohej në kampionatin shqiptar të volejbollit për femra në sezonin 2025-2026.

Me shkresën nr. 239, datë 29.09.2025, drejtuar Federatës Shqiptare të Volejbollit, Shoqata e Volejbollit Vllaznia ka paraqitur shqetësimin se gjatë zhvillimit të lojës Vllaznia-Dinamo, lojtarët dhe trajnerët kanë vënë re një forcë goditëse sulmuese mbi normalen e pritur të lojtares së ekipit Dinamo, N.F dhe kanë kërkuar “... vlerësim psikologjik; por edhe mbështetur në ekzaminime laboratorike, për konfirmimin dhe sigurimin që volejbollistja N.F po luan në grupmoshën dhe kampionatin e duhur”.

Me shkresën nr. 135/1, datë 02.10.2025, drejtuar Federatës Shqiptare të Volejbollit, Qendra Multifunktionale Pogradec sha, ka informuar Federatën se: “Në datë 11.10.2025, është parashikuar që të zhvillohet ndeshja midis ekipeve të volejbollit për femra ndërmjet Pogradecit dhe Dinamos. Nga analizimi i disa prej ndeshjeve që ka zhvilluar ekipi kundërshtar, kemi krijuar bindjen se lojtarja e ekipit Dinamo, N.F mund të përdorë substancë të ndaluar në sportin e volejbollit pasi ka të dhëna “jonormale” për një volejbolliste, prandaj kërkojmë:

- 1. FSHV të marrë masat e nevojshme për kryerjen e analizave antidoping përpara ndeshjes së datës 11.10.2025, për sportisten e Dinamos.*
- 2. Federata të bëjë të gjitha analizat e nevojshme për të vërtetuar që kjo volejbolliste është e përshtatshme për të luajtur në volejbollin e femrave pasi dyshojmë që kjo sportiste ka parametra fizikë dhe fiziologjikë të papërshtatshme për të luajtur në volejbollin e femrave, gjë që mund të sjellë dëmtime të mëdha për femrat që luajnë në këtë kategori”.*

Bordi Drejtues i Federatës Shqiptare të Volejbollit me shkresën nr. 247, datë 06.10.2025, “Mbi ekzaminimet e nevojshme për kryerjen e analizave përkatëse për vërtetimin e performancës fizike natyrale dhe përcaktimin e gjinisë për lojtaren N.F”, ka Vendosur:

- 1. Të bëhen ekzaminimet e nevojshme për kryerjen e analizave përkatëse për vërtetimin e performancës fizike natyrale dhe përcaktimin e gjinisë për lojtaren e ekipit Dinamo N.F.*

2. Ngritjen e një grupi pune për të ndjekur dhe shoqëruar sportisten përgjatë kryerjes së ekzaminimeve, me përbërjen si më poshtë:
 - E.D (Sekretar i Përgjithshëm FSHV)
 - A.T (Mjek pranë Agjencisë së Shërbimeve Sportive)
 - F.A (Mjek i ekipit Dinamo)
3. Në rast refuzimi të lojtares për të mos kryer ekzaminimet përkatëse, do të merren masa në mbështetje të Rregullave Antidoping OKAD, Rregullore VADA, Rregullore IOC, Rregulloren e Brendshme të FSHV dhe Kodit Etik dhe Disiplinës.

Grupi i Punës i ngritur sipas vendimit të Bordit Drejtues të Federatës Shqiptare të Volejbollit, në datë 15.10.2025 ka mbajtur procesverbal në të cilin informon se sportistja N.F nuk është paraqitur në ambientet e Spitalit Salus për të kryer analizat përkatëse.

Bordi Drejtues i Federatës Shqiptare të Volejbollit me shkresën nr. 260, datë 16.10.2025, “Për pezullimin e përkohshëm të lojtares së ekipit Dinamo N.F”, ka Vendosur:

1. Pezullimin e përkohshëm të lojtares së ekipit Dinamo N.F nga aktivitetet sportive, në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Bordit Drejtues (KE) nr. 247, datë 06.10.2025, pika 1, sipas së cilës ajo duhet të kryej ekzaminimet e nevojshme për vërtetimin e performancës fizike natyrale dhe përcaktimin e gjinisë.
2. Lojtares N.F i jepet një mundësi tjetër për tu paraqitur edhe njëherë ditën e Mërkurë datë 22.10.2025, ora 12:00 pranë Spitalit Salus, për të kryer ekzaminimet përkatëse.
3. Klubi Volejbollit Dinamo ngarkohet me detyrimin për të njoftuar zyrtarisht lojtaren e tij për këtë vendim dhe për detyrimin për tu paraqitur në datën e caktuar.
4. Në rast mosparaqitjeje të përsëritur, si nga lojtarja ashtu edhe Klub Volejbolli Dinamo, do të zbatohen sanksionet përkatëse sipas Rregullores së Brendshme, Kodit të Etikës dhe Rregullores së Disiplinës të Federatës Shqiptare të Volejbollit.

Grupi i Punës i ngritur sipas vendimit të Bordit Drejtues të Federatës Shqiptare të Volejbollit, në datë 22.10.2025 ka mbajtur procesverbal në të cilin informon se sportistja N.F është paraqitur në ambientet e Spitalit Salus, por nuk ka nënshkruar formularin e dakortësisë sipas protokollit spitalor që pacienti duhet të nënshkruaj që pranon ti nënshtrohet analizave përkatëse gjinore, duke mospranuar me vullnetin e saj të plotë gjithashtu as të nënshkruaj faktin që refuzon moskryerjen e analizave sipas vullnetin dhe vendimit të saj.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të sportistes N.F lidhur me kërkesën e Federatës Shqiptare të Volejbollit për t’iu nënshtruar testit të gjinisë dhe testit të testosteronit

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procedurës rezulton se znj. N.F është sportiste profesioniste e volejbollit, e aktivizuar pranë Klubit të Volejbollit Dinamo për sezonin sportiv 2025–2026, në kategorinë e femrave. Ajo është paraqitur dhe regjistruar në këtë aktivitet sportiv si lojtare femër, në bazë të dokumentacionit civil dhe sportiv të paraqitur për regjistrimin/federimin e saj, si dhe në bazë të dokumentacionit kontraktual të lidhur me klubin përkatës. Nuk rezulton që, në momentin e federimit, aktivizimit apo pjesëmarrjes fillestare në

kampionatin përkatës, FSHV të ketë konstatuar ndonjë parregullsi formale në dokumentacionin e saj, në regjistrimin e saj si sportiste femër apo në të drejtën e saj për të marrë pjesë në kampionatin e femrave.

Në vijim të zhvillimit të ndeshjes së datës 28.09.2025 ndërmjet ekipeve Vllaznia dhe Dinamo, si dhe në vijim të kërkesës së depozituar më datë 03.10.2025 nga përfaqësues të Pogradecit, Federata Shqiptare e Volejbollit është vënë në lëvizje mbi bazën e informacioneve të ngritura nga klube kundërshtarë lidhur me karakteristikat fiziologjike dhe performancën sportive të znj. N.F. Nga përgjigjja e FSHV-së rezulton se pretendimet e paraqitura nga këto subjekte kishin të bënin me perceptimin se sportistja kishte një *“forcë goditëse sulmuese mbi normalen e pritur”*, si dhe me dyshime se ajo mund të kishte *“parametra fizikë dhe fiziologjikë të papërshtatshëm për të luajtur në volejbollin e femrave”*. Në këtë kontekst, nga Federata është kërkuar kryerja e analizave për vërtetimin e performancës fizike natyrale dhe përcaktimin e gjinisë, për të verifikuar nëse sportistja ishte *“e përshtatshme”* për të luajtur në volejbollin e femrave.

Në bazë të këtyre kërkesave, Bordi Drejtues i FSHV-së, me vendimin nr. 247, datë 06.10.2025, ka vendosur kryerjen e ekzaminimeve të nevojshme për *“vërtetimin e performancës fizike natyrale dhe përcaktimin e gjinisë”* për sportisten N.F. Në vijim, Federata ka sqaruar se me përcaktim gjinor kuptohej testi i kromozomit SRY, pra verifikimi i prezencës së kromozomit Y, si dhe testi i testosteronit, pra verifikimi i nivelit të testosteronit. Nga aktet e administruara rezulton se kjo kërkesë është drejtuar në mënyrë individuale ndaj znj. N.F dhe jo si pjesë e një procedure të përgjithshme, të parashikuar paraprakisht dhe të zbatueshme në mënyrë të njëjtë për të gjitha sportistet e kampionatit apo për të gjitha rastet që lidhen me përshtatshmërinë (eligibility) në kategoritë sportive.

Komisioneri vlerëson se kjo rrethanë është thelbësore për përcaktimin e ekzistencës së trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë. Sportistja nuk është vendosur në një procedurë standarde kontrolli, të njohur paraprakisht, të zbatueshme në mënyrë të përgjithshme, të parashikuar në rregullore dhe të shoqëruar me garanci procedurale. Përkundrazi, ajo është veçuar nga sportistet e tjera dhe është bërë subjekt i një procedure të posaçme, të nisur mbi bazën e dyshimeve të ngritura nga ekipe kundërshtarë, të cilat nuk janë mbështetur në prova objektive mjekësore, juridike apo sportive, por në perceptime mbi forcën dhe performancën e saj në fushë.

Komisioneri vlerëson se performanca fizike e një sportisteje, forca goditëse, niveli i aftësive atletike, fiziku apo mënyra se si ajo perceptohet nga sportistet dhe trajnerët kundërshtarë, nuk mund të shërbejnë, në vetvete, si bazë e mjaftueshme për të vënë në dyshim gjininë e saj dhe për t’i kërkuar asaj t’i nënshtrohet testeve të tilla si testi i gjinisë (SRY) apo testi i testosteronit. Sporti konkurrues, nga vetë natyra e tij, përfshin diferenca në aftësi fizike, forcë, shpejtësi, teknikë, përgatitje dhe performancë. Pikërisht këto diferenca janë pjesë e garës sportive dhe nuk mund të kthehen automatikisht në indicie për dyshim mbi gjininë e një sportisteje, në mungesë të një baze të qartë ligjore dhe të kritereve objektive të përcaktuara paraprakisht.

Nëse perceptimi subjektiv se një sportiste është *“më e fortë se normalja”* do të konsiderohej i mjaftueshëm për të nisur një procedurë të verifikimit të gjinisë, atëherë çdo sportiste grua që ka performancë të lartë, fizikun e zhvilluar apo aftësi të spikatura sportive do të mund të vendosej

në pozitën e dyshimit, stigmatizimit dhe detyrimit për të provuar gjininë e saj. Një qasje e tillë cenon parimin e barazisë në sport, krijon standard të pasigurt për sportistet gra dhe i ekspozon ato ndaj trajtimeve të diferencuara mbi bazë perceptimesh dhe stereotipesh gjinore.

Komisioneri vlerëson se N.F është trajtuar ndryshe nga sportistet e tjera të kampionatit të femrave, pasi vetëm ndaj saj është kërkuar kryerja e testit të gjinisë dhe testit të testosteronit. Nuk rezulton që FSHV të ketë paraqitur prova se sportiste të tjera në të njëjtën kategori garimi janë vendosur në të njëjtën procedurë verifikimi, as që një procedurë e tillë të jetë zbatuar rregullisht, sipas kriterëve të përgjithshme dhe të barabarta, për të gjitha sportistet në situata të krahasueshme.

Në këtë kuptim, krahasueset relevante në rastin konkret janë sportistet e tjera të kampionatit të femrave, të cilat marrin pjesë në të njëjtin aktivitet sportiv, sipas të njëjtave rregulla të përgjithshme të regjistrimit, federimit, aktivizimit dhe konkurrimit. Ndërsa këto sportiste kanë vijuar pjesëmarrjen në aktivitet pa iu kërkuar prova shtesë mbi gjininë apo nivelin e testosteronit, znj. F është veçuar dhe është kushtëzuar në ushtrimin e aktivitetit të saj sportiv me kryerjen e testeve që prekin drejtpërdrejt trupin, të dhënat biologjike, jetën private, dinjitetin personal dhe reputacionin profesional të saj.

Komisioneri vlerëson se kërkesa për test gjinie dhe test testosteroni nuk është një kërkesë administrative e zakonshme. Ajo përbën një ndërhyrje në sferën personale, trupore dhe private të sportistes, pasi lidhet me të dhëna të ndjeshme biologjike, shëndetësore, hormonale dhe gjenetike. Për këtë arsye, një kërkesë e tillë mund të justifikohet vetëm nëse do të ekzistonte një bazë e qartë ligjore, një procedurë e miratuar paraprakisht, kriterë objektive dhe të verifikueshme për fillimin e saj, garanci të mjaftueshme procedurale për sportisten, mbrojtje e të dhënave personale dhe shëndetësore, respektim i dinjitetit dhe privatësisë, si dhe një mekanizëm efektiv ankimi për të kundërshtuar vendimmarrjen.

Nga aktet e administruara nuk rezulton se këto garanci kanë ekzistuar. FSHV ka referuar në mënyrë të përgjithshme Statutin, Rregulloren e Brendshme, Kodin e Etikës, Rregulloren e Disiplinës, rregulloret e FIVB-së dhe Ligjin për Sportin, por nuk ka identifikuar një dispozitë konkrete në aktet e saj të brendshme që të parashikojë procedurën e detajuar për kërkimin e testit të gjinisë apo testit të testosteronit ndaj një sportisteje të veçantë, mbi bazën e pretendimeve të klubeve kundërshtarë. Nuk rezulton të jetë përcaktuar qartë se kush mund ta iniciojë këtë procedurë, mbi çfarë kriteresh objektive, me çfarë standardi prove, me çfarë afatesh, me çfarë të drejtash mbrojtjeje për sportisten, me çfarë garancish për privatësinë dhe të dhënat personale, si dhe me çfarë të drejte ankimi ndaj vendimit.

Rregullorja e Brendshme e FSHV-së përcakton rregulla për organizimin e veprimtarive zyrtare kombëtare, pjesëmarrjen dhe aktivizimin e skuadrave dhe lojtarëve, transferimin e lojtarëve, dokumentacionin që duhet të paraqesin shoqatat sportive dhe sportistët, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për federim dhe aktivizim, përfshirë dokumentin e identifikimit, certifikatën mjekësore, certifikatën e transferimit, siguracionin dhe formularët përkatës. Megjithatë, nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk rezulton të jetë parashikuar një procedurë e veçantë që i jep FSHV-së kompetencë të kërkojë nga një sportiste e veçantë testin e gjinisë apo testin e

testosteronit, si kusht për vijimin e aktivitetit të saj sportiv, pas regjistrimit dhe aktivizimit në kampionat.

Statuti i FSHV-së në nenin 1, pika 2 parashikon se Federata vepron në përputhje me Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar, Kodin Civil, Ligjin për Organizatat Jofitimprurëse dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Statuti në nenin 1, pika 4 parashikon gjithashtu se FSHV është anëtare e FIVB-së dhe respekton statutet, rregulloret, direktivat dhe vendimet e tyre.

Në këtë kuadër, Komisioneri vlerëson se edhe aktet ndërkombëtare sportive të referuara nuk mund të interpretohen jashtë parimeve të barazisë dhe mbrojtjes së dinjitetit. Rregullorja Sportive 2026 e Federatës Ndërkombëtare të Volejbollit (FIVB Sports Regulations 2026) parashikon se çështjet e përshtatshmërisë (eligibility) mund të lidhen me kritere të tilla si shtetësia, mosha, seksi/gjinia, lartësia nëse aplikohet dhe kritere të tjera. Po ashtu, këto rregullore përmbajnë dispozita lidhur me seksin/përshtatshmërinë e gjinisë dhe parashikojnë procedura specifike për kategorizimin fillestar, ndryshimin e kategorizimit dhe përbërjen e një Komiteti të Përshtatshmërisë së Seksit (Sex Eligibility Committee) në rastet përkatëse. Nga vetë përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se një çështje që lidhet me seksin/përshtatshmërinë e gjinisë (sex/gender eligibility) është një çështje e ndjeshme, që kërkon procedurë të posaçme, organ të posaçëm, vlerësim të arsyetuar dhe garanci për sportistin. Këto standarde nuk justifikojnë procedura ad hoc, të nisura mbi bazën e perceptimeve të kundërshtarëve, pa kritere objektive dhe pa garanci të qarta procedurale.

Në rastin konkret, FSHV nuk ka provuar se kishte miratuar dhe zbatuar një procedurë kombëtare të barasvlershme, të qartë, të parashikueshme dhe të aksesueshme për sportistet, lidhur me përshtatshmërinë (eligibility) në kategorinë e femrave. Gjithashtu nuk rezulton që sportistes t’i jetë bërë e ditur paraprakisht, në momentin e regjistrimit apo aktivizimit, se pjesëmarrja e saj mund të kushtëzohet në çdo moment me testim të posaçëm gjenetik apo hormonal mbi bazën e perceptimeve të klubeve kundërshtarë. Kjo e vendos sportisten në një gjendje pasigurie juridike dhe procedurale dhe e bën masën e marrë ndaj saj të papajtueshme me parimin e parashikueshmërisë dhe trajtimit të barabartë.

Kodi i Etikës dhe Rregullorja e Disiplinës e FSHV-së përmbajnë detyrime të qarta për anëtarët e Federatës në lidhje me respektimin e dinjitetit⁴, integritetit, privatësisë dhe mosdiskriminimit. Sipas këtij Kodi, anëtarët e FSHV-së duhet të veprojnë në përputhje me parimet e dinjitetit, integritetit, besnikërisë dhe përgjegjësisë, ndërsa dinjiteti nënkupton respektin për veten, për të drejtën e individit dhe të drejtën e privatësisë. Kodi kërkon që çdo anëtar i FSHV-së të mbrojtë dinjitetin e çdo individi, të mos diskriminojë askënd mbi bazën e racës, gjinisë, origjinës etnike, fesë, bindjeve filozofike, opinionit politik, gjendjes civile apo çështjeve të tjera, të mos tolerojë agresion fizik, moral apo mendor, dhe të ndalojë çdo formë dhune të karakterit fizik, mendor, moral, profesional apo gjinor.

Në këtë kuptim, vetë aktet e brendshme të FSHV-së e vendosin Federatën dhe subjektet e saj nën detyrimin për të mbrojtur dinjitetin dhe privatësinë e sportistes, jo vetëm për të garantuar rregullsinë e garës. Balancimi ndërmjet integritetit të garës sportive dhe të drejtave të sportistes

⁴ Neni 2.2 Kodi i Etikës dhe Rregullorja e Disiplinës

nuk mund të bëhet duke e vendosur sportisten, pa procedurë të qartë dhe pa bazë objektive, në pozitën e detyrimit për të provuar gjininë e saj përpara Federatës, klubeve rivale dhe opinionit sportiv. Mungesa e këtyre elementeve e bën trajtimin ndaj sportistes të padrejtë dhe të pafavorshëm.

Komisioneri vlerëson gjithashtu se efekti praktik i vendimmarrjes së FSHV-së ka qenë kufizimi i drejtpërdrejtë i të drejtës së sportistes për të ushtruar aktivitetin e saj profesional sportiv. Kërkesa për testim nuk ka qenë neutrale në pasojat e saj. Ajo është shoqëruar me presionin institucional për t'iu nënshtruar analizave, me paralajmërimin për masa disiplinore në rast refuzimi dhe më pas me pezullimin e përkohshëm të sportistes nga aktivitetet sportive. Kështu, sportistja është vendosur përballë një zgjedhjeje të padrejtë: ose të pranonte një ndërhyrje në trupin, privatësinë dhe të dhënat e saj biologjike, në mungesë të një procedure të qartë dhe të garantuar, ose të humbiste të drejtën për të vijuar aktivitetin sportiv.

Një zgjedhje e tillë nuk mund të konsiderohet ushtrim i lirë dhe i barabartë i të drejtave sportive dhe profesionale. Përkundrazi, ajo përbën vendosjen e sportistes në një pozitë të pafavorshme, pasi vetëm ajo, ndryshe nga sportistet e tjera, u detyrua të përballej me një procedurë të posaçme verifikimi mbi gjininë dhe karakteristikat hormonale, si kusht për të vijuar pjesëmarrjen në kampionatin e femrave. Ky trajtim e ka cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pozitën e saj sportive, profesionale dhe personale.

Komisioneri vëren se FSHV ka argumentuar se veprimet e saj janë ndërmarrë për të garantuar integritetin e garës, sigurinë e sportisteve të tjera dhe zhvillimin e rregullt të kampionatit. Megjithatë, një qëllim i tillë, edhe kur mund të konsiderohet legjitim në abstrakt, nuk e përjashton detyrimin e Federatës për të vepruar në mënyrë të ligjshme, të arsyeshme, proporcionale dhe jodiskriminuese. Mjeti i zgjedhur nga Federata duhet të ishte i përshtatshëm, i domosdoshëm dhe proporcional me situatën konkrete. Në rastin në shqyrtim, Federata nuk ka provuar se kërkesa për testin e gjinisë dhe testosteronit ishte i domosdoshëm, se nuk kishte mjete më pak ndërhyrëse, se ekzistonte një bazë objektive e mjaftueshme për të vënë në dyshim përshtatshmërinë e sportistes, apo se procedura ishte e parashikuar në mënyrë të qartë dhe e zbatueshme në mënyrë të barabartë për të gjitha rastet e ngjashme.

Përkundrazi, nga aktet rezulton se vendimmarrja është iniciuar nga ankesa dhe perceptime të klubeve kundërshtarë, të cilat kishin interes të drejtpërdrejtë sportiv në rezultatin e garës dhe në pjesëmarrjen e sportistes në kampionat. Federata, në vend që t'i trajtonte këto pretendime me kujdesin e kërkuar nga parimi i dinjitetit dhe mosdiskriminimit, i ka kthyer ato në bazë për një ndërhyrje ndaj sportistes. Kjo qasje ka prodhuar efekt të pafavorshëm dhe stigmatizues ndaj saj, pasi e ka vendosur sportisten nën dyshim publik dhe institucional për vetë përkatësinë e saj në kategorinë e femrave.

Komisioneri çmon se rrethanat e mësipërme tregojnë jo vetëm një dallim formal në trajtim, por edhe një dëm konkret në pozitën e sportistes. Ajo është veçuar nga grupi i sportisteve të tjera; i është kërkuar të kryejë teste të lidhura me gjininë, kromozomet dhe nivelin hormonal; është vendosur përballë mundësisë së sanksionimit në rast refuzimi; është pezulluar nga aktivitetet

sportive; dhe është cenuar në reputacionin e saj profesional, dinjitetin personal dhe të drejtën për të garuar në kushte të barabarta.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se refuzimi i sportistes për t'iu nënshtruar një procedure të tillë, në kushtet kur procedura nuk rezulton të ketë qenë e parashikuar qartë, e arsytuar në mënyrë objektive dhe e shoqëruar me garanci të plota, nuk mund të përdoret si bazë për ta rënduar më tej pozitën e saj. Nëse kërkesa fillestare për testim është e pajustificuar, e paqartë dhe e pabarabartë, atëherë edhe masa e marrë për pezullimin e saj merr të njëjtën natyrë të pafavorshme dhe të padrejtë. Një person nuk mund të penalizohet për refuzimin e një ndërhyrjeje që prek trupin, privatësinë, dinjitetin dhe të dhënat e tij biologjike, në mungesë të një baze të qartë ligjore dhe procedurale.

Në përfundim të analizës, Komisioneri vlerëson se provohet se sportistja N.F është vendosur në pozita të padrejta, të pafavorshme dhe të pabarabarta në raport me sportistet e tjera të kampionatit të femrave nga Federata Shqiptare e Volejbollit. Ky trajtim konsiston në kërkesën individuale që vetëm ajo t'i nënshtrohej testit të gjinisë dhe testit të testosteronit, në mungesë të një procedure të përgjithshme, të qartë, të parashikueshme dhe të zbatueshme në mënyrë të barabartë për të gjitha sportistet në situata të krahasueshme. Trajtimi i saj është bazuar në perceptime mbi performancën e saj në fushë, pa u mbështetur në kritere objektive të përcaktuara paraprakisht dhe pa respektuar garancitë e nevojshme për dinjitetin, privatësinë, barazinë dhe sigurinë juridike.

B. Shkaku i mbrojtur

Ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, sipas përmbajtjes në vijim: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në analizën e çështjeve të diskriminimit, Komisioneri vlerëson se shkaku i mbrojtur nuk identifikohet vetëm nga mënyra se si personi e deklaroi veten, por edhe nga mënyra se si subjekti kundër të cilit drejtohet ankesa e ka perceptuar, kategorizuar apo trajtuar atë. Pra, për të përcaktuar shkahun e mbrojtur, nuk është e domosdoshme që personi të provojë një karakteristikë biologjike, shëndetësore apo identitare të caktuar. Mjafton që trajtimi i pafavorshëm të jetë nxitur, ndikuar ose arsytuar nga një karakteristikë reale, e supozuar apo e perceptuar, e cila përfshihet në listën e shkaqeve të mbrojtura nga ligji.

Në rastin konkret, nga aktet e administruara rezulton se znj. N.F është sportiste grua, e regjistruar në dokumentet e saj civile dhe sportive si femër, dhe e aktivizuar në karrierën e saj sportive në kategorinë e femrave. Ajo ka marrë pjesë në aktivitetin sportiv në Shqipëri si lojtare e Klubit të Volejbollit Dinamo, në kampionatin e femrave, dhe nuk rezulton që gjatë procedurës së federimit

apo regjistrimit të saj të jetë konstatuar ndonjë parregullsi në dokumentacionin që lidhet me gjininë apo të drejtën për të garuar në këtë kategori.

Megjithatë, vendimmarrja e Federatës Shqiptare të Volejbollit nuk është fokusuar në një problem formal dokumentacioni apo në një shkelje konkrete sportive, por në dyshimin mbi gjininë, karakteristikat biologjike, trupore dhe hormonale të sportistes. Ky element del qartë nga vetë objekti i vendimit të Bordit Drejtues të FSHV-së, i cili ka kërkuar kryerjen e ekzaminimeve për “vërtetimin e performancës fizike natyrale dhe përcaktimin e gjinisë” së znj. N.F. Po ashtu, nga përgjigjja e Federatës rezulton se me “përcaktim gjinor” është kuptuar testi i kromozomit SRY, pra verifikimi i prezencës së kromozomit Y, si dhe testi i testosteronit, pra verifikimi i nivelit të testosteronit.

Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se shkak kryesor i mbrojtur që mbart znj. N.F, është gjinia dhe karakteristikat e seksit, të lidhura me karakteristikat biologjike, trupore, hormonale dhe gjenetike të perceptuara apo të supozuara nga subjektet që kanë vënë në dyshim pjesëmarrjen e saj në kampionatin e femrave.

Gjinia përbën një shkak të mbrojtur, pasi është e parashikuar në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe e gjithë procedura e ndjekur ndaj sportistes është ndërtuar mbi vënien në dyshim të faktit nëse ajo mund të luante në kategorinë e femrave.

Karakteristikat e seksit përbëjnë gjithashtu shkak të mbrojtur në këtë rast, pasi masat e kërkuara nga Federata kishin për objekt pikërisht elementë biologjikë të trupit të sportistes, përfshirë kromozomet dhe nivelin hormonal. Testi SRY dhe testi i testosteronit lidhen drejtpërdrejt me karakteristika biologjike të seksit, të cilat janë të dhëna intime, të ndjeshme dhe të lidhura me trupin, integritetin fizik dhe privatësinë e personit. Për këtë arsye, edhe nëse Federata nuk ka përdorur shprehimisht termin “karakteristika të seksit”, vetë natyra e analizave të kërkuara tregon se trajtimi i sportistes është lidhur me karakteristikat e saj të supozuara biologjike dhe seksuale.

Në rastin konkret, shkak i mbrojtur nuk lidhet vetëm me një karakteristikë të provuar apo faktikisht të verifikuar të sportistes, por edhe me karakteristika të supozuara apo të perceptuara. Në këtë rast, pikërisht supozimi se sportistja mund të mos i përkiste, sipas perceptimit të klubeve kundërshtarë dhe më pas të Federatës, kategorisë së femrave, ka qenë elementi që ka vënë në lëvizje vendimmarrjen ndaj saj.

Në këtë aspekt, Komisioneri vlerëson se shkak i mbrojtur shfaqet në formë të ndërthurur. Trajtimi i znj. N.F lidhet njëkohësisht me gjininë dhe karakteristikat e seksit. Këto shkaqe nuk veprojnë të ndara mekanikisht nga njëra-tjetra, por ndërthuren në mënyrën se si sportistja është parë dhe trajtuar. Dyshimet ndaj saj janë ngritur për shkak të perceptimit mbi forcën fizike, performancën sportive, parametrat truporë dhe fiziologjikë, si dhe supozimin se këto karakteristika nuk përputheshin me stereotipin e pritshëm për një sportiste grua.

Në këtë mënyrë, shkak i mbrojtur në rastin e znj. N.F, identifikohet si gjinia dhe karakteristikat e seksit. Këto shkaqe janë të mbrojtura nga ligji 10221/2010, i ndryshuar dhe janë drejtpërdrejt të lidhura me rastin, pasi vendimi për t’i kërkuar sportistes testin e gjinisë dhe testin e testosteronit

nuk do të ishte marrë nëse nuk do të ishte vënë në dyshim përkatësia e saj në kategorinë e femrave dhe nëse nuk do të ishin ngritur dyshime mbi trupin, fiziologjinë dhe karakteristikat e saj seksuale.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se shkak i diskriminimit gjinia dhe karakteristikat e seksit të sportistes, janë shkaqe të mbrojtura nga ligji dhe ekzistenca e tyre rezulton e provuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkaqet e mbrojtura

Neni 18, i Kushtetutës, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke u shprehur se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlijje e arsyeshme dhe objektive”*.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Neni 17, i Kushtetutës, përcakton: *“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Mbështetur në nenin 17, të Kushtetutës, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), zë një vend të veçantë në hierarkinë e normave juridike. KEDNJ-ja, nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8 *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”*.

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina*

kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Protokolli 12-të i KEDNJ, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “*a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përlligjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁵. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁶. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk

⁵ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁶ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”⁷.

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme⁸.

LMD (neni 3, pika 1), e përkufizon diskriminimin si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*

Në nenin 3, pika 3, të LMD, përcaktohet: *“Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.*

Në nenin 6, pika 1, të LMD përcaktohet se: *“1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

LMD e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës dhe është hartuar nën frymën e tij. Vendi ynë si vend anëtar i Këshillit të Evropës dhe që ka ratifikuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duhet që të veprojë në përputhje me Konventën dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si organi që mbikëqyr zbatimin e saj.

Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Në të njëjtën frymë është dhe ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

⁷ Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.*

⁸ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin⁹.

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara*”¹⁰. Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t’i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës.

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ka mbajtur qëndrimin se: “*...aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë*

⁹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁰ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147.

GjEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi”.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standardin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë çështje.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar:

Së pari, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e FSHV-së.

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë i subjektit ankues, nga ana e FSHV-së, lidhet me shkaqet e mbrojtura dhe nuk justifikohet objektivisht.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se sportistja N.F është vendosur në pozita të padrejta, të pafavorshme dhe të pabarabarta nga Federata Shqiptare e Volejbollit, sepse vetëm asaj i është kërkuar që ti nënshtrohej testit të gjinisë dhe testit të testosteronit, në mungesë të një procedure të përgjithshme, të qartë, të parashikueshme dhe të zbatueshme në mënyrë të barabartë për të gjitha sportistët në situata të krahasueshme dhe ky trajtim është bazuar në perceptime dhe dyshime mbi karakteristikat fiziologjike dhe performancën sportive, pa u mbështetur në kritere objektive të përcaktuara paraprakisht dhe pa respektuar garancitë e nevojshme për dinjitetin, privatësinë, barazinë dhe sigurinë juridike.

Bazuar në analizën e pikës B të vendimit, Komisioneri vlerëson se znj. N.F mbart shkaqet e mbrojtura nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përkatësisht gjinia dhe karakteristikat e seksit.

Në çështjet e diskriminimit, mbrojtja ligjore shtrihet edhe ndaj karakteristikave të perceptuara, të supozuara apo të atribuuara personit nga të tjerët. Për rrjedhojë, edhe nëse një person nuk mbart faktikisht një karakteristikë të caktuar biologjike, hormonale apo gjenetike, ai mbrohet nga ligji nëse trajtimi i pafavorshëm ka ardhur si pasojë e dyshimeve, perceptimeve apo supozimeve mbi këtë karakteristikë.

Në rastin konkret, sportistja nuk është veçuar për shkak të një shkeljeje të rregullave të lojës, të disiplinës sportive, të dokumentacionit të transferimit apo të ndonjë parregullsie të konstatuar gjatë federimit. Ajo është veçuar për shkak të dyshimeve mbi gjininë, karakteristikat fiziologjike dhe hormonale të saj. Kërkesa që vetëm znj. N.F t’i nënshtrohej testit të gjinisë dhe testit të

testosteronit është për nga objekti dhe pasojat, e lidhur drejtpërdrejt me shkaqet e mbrojtura të gjinisë dhe karakteristikave të seksit.

Komisioneri vlerëson se, kur një sportiste grua veçohet nga sportistet e tjera dhe i kërkohet të provojë gjininë e saj për shkak se perceptohet si fizikisht më e fortë, më dominuese apo me karakteristika trupore që nuk përputhen me pritshmëritë stereotipike mbi feminitetin, veprimet e FSHV-së lidhen me gjininë dhe karakteristikat e seksit. Në këtë rast, sportistja është vënë në dyshim jo për shkak të një fakti objektiv të konstatuar, por për shkak të një perceptimi mbi performancën e saj.

Shkaku “gjinia” është i pranishëm sepse kërkesa për testim synonte të verifikonte nëse znj. N.F mund të konsiderohej e përshtatshme për të luajtur në kategorinë e femrave. Pra, trajtimi i saj u ndërtua mbi vënien në dyshim të statusit të saj si grua sportiste në një kategori sportive për femra. Nëse sportistja nuk do të ishte grua që garonte në kategorinë e femrave, një kërkesë e tillë nuk do të ishte ngritur në këtë formë. Kështu, gjinia e saj, e perceptuar dhe e vënë në dyshim, përbën një element të drejtpërdrejtë.

Shkaku “karakteristikat e seksit” është gjithashtu i pranishëm, pasi Federata nuk ka kërkuar thjesht një verifikim administrativ të dokumentacionit, por ka kërkuar ekzaminime të lidhura me elementë biologjikë dhe gjenetikë të personit. Testi i gjinisë, që lidhet me verifikimin e prezencës së kromozomit Y, dhe testi i testosteronit, që lidhet me nivelin hormonal, kanë për objekt karakteristika intime biologjike, gjenetike dhe hormonale të sportistes. Këto karakteristika janë të mbrojtura nga ligji, si pjesë e karakteristikave të seksit, por edhe në lidhje me të dhënat sensitive të jetës private.

Komisioneri çmon se ky rast paraqet një ndërthurje të shkaqeve të mbrojtura. Gjinia, karakteristikat e seksit dhe elementët biologjikë, hormonalë dhe gjenetikë nuk mund të ndahen artificialisht nga njëri-tjetri. Dyshimi mbi gjininë e sportistes u ngrit për shkak të perceptimeve mbi performancën e saj; kërkesa për verifikim u konkretizua përmes testeve mbi kromozomet dhe testosteronin; ndërsa pasoja ishte kufizimi i pjesëmarrjes së saj në aktivitet sportiv si grua. Këto shkaqe kanë vepruar së bashku dhe kanë prodhuar një formë të veçantë të trajtimit të pafavorshëm.

Në analizën e Komisionerit, krahasueset relevante janë sportistet e tjera të kampionatit të femrave, të cilat ndodheshin në situatë të njëjtë apo të ngjashme me znj. N.F sa i përket pjesëmarrjes në të njëjtën kategori garimi, në të njëjtën veprimtari sportive dhe nën të njëjtën autoritet rregullator të FSHV-së. Ndryshe nga ato, znj. N.F u veçua dhe iu kërkua t’i nënshtrohej testit të gjinisë dhe testit të testosteronit. Diferenca në trajtim nuk lidhej me një kriter të përgjithshëm që zbatohet për të gjitha sportistet, por me dyshimet e ngritura ndaj saj për shkak të karakteristikave të perceptuara të trupit, gjinisë dhe seksit të saj.

Për sa më sipër, mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerësoi se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ana e FSHV-së.

Komisioneri vlerëson se është e rëndësishme të analizohet edhe raporti ndërmjet veprimeve të FSHV-së dhe parashikimeve të dokumentit “FIVB Sports Regulations 2026”, 8 May 2026, të cilit Federata i referohet si pjesë e kuadrit ndërkombëtar rregullator të volejbollit.

Sipas nenit 1.1 të FIVB Sports Regulations 2026, FIVB është autoriteti suprem në volejboll për të vendosur mbi të gjitha çështjet dhe mosmarrëveshjet që lidhen me përshtatshmërinë e lojtarëve për kompeticionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Neni 1.2 parashikon se çdo federatë kombëtare ka të drejtë të përcaktojë përshtatshmërinë e lojtarëve të saj, por kjo e drejtë ushtrohet në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloret e FIVB-së. Neni 1.3 parashikon se përshtatshmëria e një lojtari mund të përcaktohet duke marrë në konsideratë, ndër të tjera, shtetësinë, moshën, seksin, lartësinë nëse aplikohet, dhe kritere të tjera të përshtatshmërisë.

Nga këto dispozita rezulton se FIVB pranon rëndësinë e kritereve të përshtatshmërisë, përfshirë seksin/gjininë, por nuk i jep federatave kombëtare një diskrecion të pakufizuar për të vepruar në mënyrë të rastësishme apo të pabarabartë. Përkundrazi, e drejta e federatave kombëtare për të përcaktuar përshtatshmërinë duhet të ushtrohet në një kuadër të parashikueshëm, të rregulluar, të arsyetuar dhe në përputhje me rregullat e FIVB-së dhe legjislacionin e zbatueshëm kombëtar.

Po në nenin 3.2.1, FIVB shprehet se, përmes kësaj rregulloreje, ajo nuk synon të përcaktojë seksin apo gjininë e një individi, por të krijojë kritere përshtatshmërie për pjesëmarrje në një kategori të caktuar seksi. Ky dallim është me rëndësi të veçantë për rastin konkret. Federata nuk mund të kthejë një procedurë përshtatshmërie në një procedurë të përgjithshme të “provimit” të gjinisë së një personi, aq më pak mbi bazën e dyshimeve subjektive të klubeve kundërshtarë. Çështja e përshtatshmërisë duhet të trajtohet si çështje procedurale sportive, me kritere të qarta dhe garanci, jo si vënie në dyshim e identitetit, trupit dhe dinjitetit të sportistes.

Neni 3.2.2.1 i FIVB Sports Regulations 2026 jep përkufizimet për “seksin” dhe “gjininë”. Sipas kësaj dispozite, “seksi” nënkupton karakteristikat biologjike dhe gjenetike, si kromozomet dhe hormonet, që zakonisht kategorizojnë një person si mashkull ose femër dhe caktohen në lindje. Ndërsa “gjinia” nënkupton identifikimin social ose psikologjik të një individi në një kategori gjinore, i cili mund të jetë i njëjtë ose i ndryshëm nga seksi i individit. Këto përkufizime tregojnë qartë se rregullimi prek fusha jashtëzakonisht të ndjeshme të jetës private, integritetit personal, trupit, karakteristikave biologjike, hormonale dhe gjenetike.

Në rastin konkret, FSHV, duke kërkuar testin e gjinisë dhe testin e testosteronit, ka ndërhyrë pikërisht në fushën që FIVB e përkufizon si “seksi”, pra në karakteristikat biologjike dhe gjenetike të sportistes. Për rrjedhojë, është e pamundur të pretendohet se trajtimi nuk lidhet me shkaqet e mbrojtura. Vetë kuadri i FIVB-së e pranon se këto çështje lidhen me kromozonet, hormonet, seksin dhe gjininë; pra me elementë që ligji shqiptar i mbron shprehimisht si gjini dhe karakteristika të seksit.

Neni 3.2.3 i FIVB Sports Regulations 2026 parashikon “Kategorizimin fillestar”, sipas të cilit kategorizimi fillestar i seksit të një lojtari për qëllime përshtatshmërie dëshmohe mbi bazën e testit SRY. Dispozita parashikon se prezenca e kromozomit Y nënkupton që lojtari është fillimisht i përshtatshëm vetëm për kategorinë e meshkujve, ndërsa mungesa e kromozomit Y nënkupton

që lojtari është i përshtatshëm për kategorinë e femrave. Po në këtë dispozitë, parashikohet se federatat kombëtare janë përgjegjëse për të demonstruar përshtatshmërinë e sportistëve që propozojnë për t'i aktivizuar në një kategori gare dhe për të siguruar rezultatet e testit SRY nga laboratorë të miratuar nga FIVB ose konfederata përkatëse, si pjesë e kontrollit të përshtatshmërisë.

Megjithatë, kjo dispozitë nuk mund të lexohet e shkëputur nga pjesa tjetër e rregullores dhe nga legjislacioni kombëtar për mosdiskriminimin. Së pari, vetë FIVB e vendos këtë si pjesë të një sistemi përshtatshmërie dhe jo si procedurë të rastësishme, individuale dhe të aktivizuar nga perceptimet e kundërshtarëve. Së dyti, neni 3.2.3 parashikon që, për kompeticionet e klubeve, federata kombëtare duhet të sigurojë që klubet brenda juridiksionit të saj të japin testin e kërkuar SRY, gjë që nënkupton një rregullim të përgjithshëm, të njohur dhe të zbatueshëm në mënyrë të barabartë, jo një masë selektive ndaj vetëm një sportisteje. Së treti, në shënimin përkatës të nenit 3.2.3, FIVB parashikon se detyrimi që federatat kombëtare të jenë përgjegjëse për ofrimin e rezultateve të testit SRY për çdo lojtar që dëshirojnë të aktivizojnë do të fillojë nga sezoni 2026 i ekipeve kombëtare. Kjo tregon se vetë sistemi i FIVB-së kërkon fazë zbatimi, rregullim të përgjithshëm dhe procedura të qarta, jo veprime të veçuara ad hoc.

Neni 3.2.3 parashikon gjithashtu se, nëse autoriteti/delegati mjekësor i një kompeticioni ka arsye të vlefshme mjekësore, si vlerësimi mjekësor i zhvillimit fiziologjik, informacion nga palë të treta, prova për mashtrim lidhur me rezultatin e testit SRY, ose mungesë të testit SRY në momentin e paraqitjes së listës fillestare, ai mund t'i kërkojë FIVB-së ose konfederatës të kryejë një test të pavarur SRY në mënyrë konfidenciale. Kjo dispozitë përmban disa garanci të rëndësishme: kërkohet një rol specifik i autoritetit mjekësor, ekzistenca e arsyeve të vlefshme mjekësore ose provave për mashtrim, si dhe kryerja e procedurës në mënyrë konfidenciale.

Në rastin konkret, nuk rezulton që kërkesa ndaj znj. N.F të jetë iniciuar nga një autoritet mjekësor mbi bazë vlerësimi mjekësor objektiv, as që të ketë pasur prova për mashtrim në dokumentacionin e saj, as që të ketë ekzistuar një procedurë e miratuar paraprakisht për të gjitha sportistet. Përkundrazi, procedura rezulton të jetë nisur nga ankesat e klubeve kundërshtarë mbi forcën dhe parametrat fizikë të sportistes. Kjo e largon rastin konkret nga logjika e nenit 3.2.3 të FIVB-së, i cili kërkon bazë mjekësore, procedurë të rregulluar dhe konfidencialitet.

Këto dispozita tregojnë se FIVB e koncepton trajtimin e çështjeve që lidhen me përshtatshmërinë e seksit/gjinisë si një procedurë të specializuar, të arsyetuar dhe të garantuar, e cila përfshin ekspertizë ligjore, mjekësore dhe përfaqësim të sportistëve. Në rastin konkret:

- nuk rezulton që FSHV të ketë ngritur një organ të tillë të pavarur dhe të specializuar;
- nuk rezulton që sportistes t'i jetë ofruar një procedurë me vendim të arsyetuar nga një komitet i ngjashëm;
- nuk rezulton që të jetë bërë një analizë e “tërësisë së rrethanave”;
- nuk rezulton që të jenë garantuar standardet e konfidencialitetit, dëgjimit efektiv dhe mbrojtjes së dinjitetit.

Për më tepër, neni 3.2.6 i FIVB Sports Regulations 2026 parashikon shprehimisht zbatueshmërinë e rregullit të seks/gjini, duke sqaruar se aplikimi i tij kufizohet në kompeticionet FIVB, World dhe Official Competitions të organizuara nga FIVB, konfederatat dhe shoqatat zonale. Për kompeticionet kombëtare të klubeve, çdo federatë kombëtare përgjegjëse për regjistrimin e lojtarëve në kompeticionin e klubeve në territorin e saj përcakton vetë rregullat e përshtatshëmërisë në lidhje me gjininë. Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme për rastin në shqyrtim, pasi ngjarja lidhet me një kampionat kombëtar klubesh në Shqipëri.

Nga kjo rrjedh se FSHV nuk mund të mbështetet në mënyrë mekanike të FIVB Sports Regulations 2026 për të justifikuar një procedurë individuale, selektive dhe ad hoc, pa pasur vetë një rregull kombëtar të miratuar, të qartë, të parashikueshëm, të botuar, të aksesueshëm dhe të zbatueshëm në mënyrë të barabartë për të gjithë. Për kompeticionet kombëtare të klubeve, barra bie mbi federatën kombëtare që të përcaktojë rregulla të veta të përshtatshëmërisë në lidhje me gjininë, por këto rregulla duhet të jenë në përputhje me legjislacionin shqiptar, përfshirë ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, të drejtën për dinjitet, privatësi, trajtim të barabartë dhe garanci procedurale.

Në rastin konkret, FSHV nuk ka provuar se, para vendimmarrjes ndaj znj. N.F, kishte miratuar një rregull të tillë kombëtar për përshtatshëmërinë gjinore në kampionatet e klubeve; nuk ka provuar se rregulli ishte i aksesueshëm për klubet dhe sportistët; nuk ka provuar se ai zbatohet në mënyrë të përgjithshme për të gjitha sportistët; dhe nuk ka provuar se procedura për test SRY apo testosteron ishte e shoqëruar me garanci të qarta procedurale, mjekësore, ligjore dhe etike. Për rrjedhojë, referimi i përgjithshëm të FIVB nuk e justifikon trajtimin e diferencuar të sportistes.

Komisioneri vlerëson se standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen Semenya kundër Zvicrës¹¹ janë relevante për analizën e këtij rasti, edhe pse rrethanat faktike dhe procedurale nuk janë identike. Çështja Semenya lidhet me një sportiste me dallime në zhvillimin seksual, e cila u prek nga rregullat e World Athletics që kërkonin uljen e nivelit natyral të testosteronit për të garuar në disa gara të kategorisë së femrave. Çështja e saj përfshinte pikërisht ndërthurjen e sportit, trupit, seksit biologjik, hormoneve, dinjitetit, privatësisë, barazisë dhe të drejtës për një mjet efektiv ankimi.

Në vendimin e Dhomës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të datës 11 korrik 2023, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 14 të Konventës, në lidhje me nenin 8, si dhe shkelje të nenit 13, duke theksuar se ankuesja nuk kishte përfituar nga garancitë e mjaftueshme institucionale dhe procedurale për shqyrtimin efektiv të pretendimeve të saj për diskriminim. Edhe pse ky vendim më pas iu referua Dhomës së Madhe, ai mbetet i rëndësishëm për standardin material që thekson: *“rregullat sportive që prekin karakteristikat biologjike dhe hormonale të sportistëve gra, sidomos kur lidhen me pjesëmarrjen në kategorinë e femrave, ngrenë çështje serioze të privatësisë, dinjitetit dhe mosdiskriminimit”*.

Në vendimin e Dhomës së Madhe të datës 10 korrik 2025, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e kufizoi juridiksionin e saj ndaj Zvicrës kryesisht te neni 6, paragrafi 1, i Konventës, duke vlerësuar se ankesat materiale sipas nenit 8, nenit 13 dhe nenit 14 ishin të papranueshme për

¹¹ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-244348%22%7D>

shkak të mungesës së lidhjes së mjaftueshme juridiksionale me Zvicrën në raport me përmbajtjen e rregullave të World Athletics. Megjithatë, Dhoma e Madhe konstatoi shkelje të nenit 6, paragrafi 1, pasi ankuesja nuk kishte përfituar nga një shqyrtim gjyqësor mjaftueshëm rigoroz dhe efektiv i çështjes së saj nga Gjykata Federale Zvicerane.

Për rastin konkret, rëndësia e vendimit të Dhomës së Madhe në Semenya nuk qëndron te zgjidhja e çështjes së vlefshmërisë së rregullave të World Athletics, pasi Gjykata nuk i rrëzoi ato rregulla dhe nuk u shpreh në themel për nenet 8 dhe 14. Rëndësia qëndron te standardi procedural që Gjykata vendosi: *“kur rregullat sportive dhe vendimmarrja e organeve sportive prekin të drejta themelore të sportistit, përfshirë dinjitetin njerëzor, integritetin trupor dhe psikologjik, identitetin, vetëvendosjen dhe ushtrimin e aktivitetit profesional, organet shqyrtuese duhet të bëjnë një kontroll veçanërisht rigoroz, të arsyetuar dhe efektiv”*.

Ky standard është drejtpërdrejt i aplikueshëm në arsyetimin e këtij vendimi. Znj. N.F u përball me një kërkesë që prekte trupin, të dhënat biologjike, hormonale dhe gjenetike, dinjitetin, identitetin si sportiste grua dhe mundësinë për të ushtruar aktivitetin profesional sportiv. Për rrjedhojë, FSHV kishte detyrimin të vepronte me kujdes të shtuar, të siguronte bazë të qartë ligjore, procedurë të parashikueshme, konfidencialitet, të drejtë dëgjimi, arsyetim të vendimit, vlerësim mjekësor dhe ligjor të specializuar, si dhe mjet efektiv ankimi. Mungesa e këtyre garancive e bën trajtimin e saj jo vetëm të pafavorshëm, por edhe të lidhur me shkaqet e mbrojtura dhe të papajtuështëm me standardet evropiane të të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst, argumenti i Federatës se masa synonte mbrojtjen e integritetit të garës dhe sigurisë së sportisteve të tjera nuk mjafton për të ndërprerë lidhjen me shkakun e mbrojtur. Edhe një qëllim i pretenduar si legjitim duhet të realizohet me mjete të përshtatshme, të domosdoshme dhe proporcionale. Nëse mjete të zgjedhur është testimi selektiv i një sportisteje, i nxitur nga perceptime mbi trupin dhe performancën e saj, në mungesë të rregullave të përgjithshme dhe garancive procedurale, atëherë trajtimi i ndryshëm nuk justifikohet objektivisht dhe mbetet i lidhur me shkaqet e mbrojtura.

Komisioneri vlerëson se FSHV nuk ka provuar se kërkesa ndaj znj. N.F ishte pjesë e një politike të përgjithshme dhe neutrale të përshtatshmërisë të zbatuar ndaj të gjitha sportisteve. Nuk është provuar se të gjitha lojtaret e kampionatit të femrave i nënshtroheshin të njëjtit kontroll SRY apo hormonal. Nuk është provuar se ekzistonte një rregull i publikuar dhe i barabartë për rastet kur mund të kërkohej testim. Nuk është provuar se sportistes iu ofrua një organ i pavarur, i specializuar dhe i arsyetuar për shqyrtimin e çështjes. Nuk është provuar se masa ishte e fundit, e domosdoshme dhe proporcionale. Në mungesë të këtyre elementeve, trajtimi i saj mbetet i pajustificuar.

Komisioneri vlerëson se lidhja shkakësore provohet edhe nga fakti se pasoja e trajtimit të pafavorshëm ishte kufizimi i pjesëmarrjes së saj si sportiste grua në kampionatin e femrave. Pra, trajtimi nuk pati një efekt të përgjithshëm administrativ, por ndikoi drejtpërdrejt në të drejtën e saj për t'u njohur, pranuar dhe trajtuar si pjesë e kategorisë së femrave. Kjo pasojë është e lidhur në mënyrë të pandashme me gjininë dhe karakteristikat e seksit.

Komisioneri, në përfundim të analizimit të të gjithë elementëve të çështjes, vlerëson se jemi në kushtet e nenit 3, pika 3 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “*Diskriminim ndërsektorial*” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit”.

Komisioneri vlerëson se nga informacioni i dërguar nga ana e FSHV-së, në asnjë rast nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkaqeve të mbartura nga sportistja N.F, që janë gjinia dhe karakteristikat e seksit dhe trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e FSHV-së.
- Që veprimet dhe mosveprimet e FSHV-së kundrejt sportistes N.F justifikohen objektivisht.

Komisioneri vlerëson se trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë ndaj znj. N.F lidhet drejtpërdrejt me shkaqet e mbrojtura të gjinisë dhe karakteristikave të seksit, të perceptuara apo të supozuara, të ndërthurura me elementë biologjikë, hormonalë dhe gjenetikë. Kërkesa për testin e gjinisë dhe testin e testosteronit nuk ishte një masë neutrale, por një masë që kishte për objekt pikërisht verifikimin e karakteristikave të mbrojtura të sportistes. Kjo kërkesë u nxit nga perceptime mbi performancën e saj dhe u zbatua vetëm ndaj saj, pa një procedurë të përgjithshme, të qartë, të barabartë dhe të garantuar.

Për rrjedhojë, Komisioneri konstaton se është provuar lidhja ndërmjet trajtimit të diferencuar dhe shkaqeve të mbrojtura. Znj. N.F është vendosur në pozitë të padrejtë, të pafavorshme dhe të pabarabartë jo si pasojë e një rregulli neutral të zbatuar njësoj për të gjithë, por si pasojë e dyshimeve të ngritura mbi gjininë dhe karakteristikat e seksit të perceptuar apo të supozuar.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se znj. N.F, në referencë të dispozitave të posaçme të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, është ekspozuar para veprimit diskriminues nga ana e FSHV-së, e për rrjedhojë, Federata Shqiptare e Volejbollit, ka shkelur dispozitat ligjore të LMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të znj. N.F, për shkak të gjinisë dhe karakteristikave të seksit, në formën e diskriminimit ndërsektorial, nga ana e Federatës Shqiptare të Volejbollit.
2. Federata Shqiptare e Volejbollit të hartojë dhe miratojë, një procedurë të posaçme, të qartë dhe jodiskriminuese për trajtimin e çështjeve të përshtatshme që lidhen me gjininë dhe

karakteristikat e seksit, duke garantuar kritere objektive, proporcionalitet, konfidencialitet, mbrojtje të dinjitetit dhe privatësisë, të drejtën për t'u dëgjuar dhe ankim efektiv, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar, legjislacionin shqiptar dhe standardet e FIVB-së.

3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Federata Shqiptare e Volejbollit, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)